



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT

(Prill 2020 - mars 2021)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit.
Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

Shkurt 2020



Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale	4
3	Bilanci i Energjisë	4
3.1	Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar	5
4	Përshtatjet e rregullta	6
4.1	Përshtatjet për normën e inflacionit.....	6
4.2	Përshtatjet tjera në OPEX	6
4.3	Investimet kapitale.....	7
4.4	Faktori ndarës i kursimeve.....	7
4.1	Fondi për BRE.....	7
4.2	Përshtatjet e kostove të humbjeve.....	8
4.3	Përshtatjet për të hyrat jo tarifore	9
4.4	Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave	10
5	Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së	11



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshatjet e Rregullta Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga Kompanitë e Rregulluara. Në këtë proces, ZRRE-ja do të bëjë propozimin fillestar për MAR-in e azhurnuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Ky vlerësim fillestar bazohet në propozimet e dorëzuara nga kompanitë e rregulluara si dhe vendimet për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2018-2022.

Rregullimi i Çmimit është mjet që përdoret nga ZRRE në mënyrë që të përcaktohen Të Hyrat e Lejuara Maksimale – MAR, të cilat Kompanitë e Rregulluara do ti mbledhin për ofrimin e shërbimeve të rregulluara. MAR caktohet në nivelin që mundëson të licencuarit e rregulluar t'i mbulojë kostot e arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes së aseteve të tyre dhe të realizojnë kthim të arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqet e efikasitetit dhe caqet për zvogëlimin e humbjeve, përmirësimin e performancës, të cilat synojnë ngritjen e efikasitetit operativ të kompanive dhe të ofrojnë nxitje për arritjen e caqeve apo ndëshkime nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë ato.

Vlerat bazë për komponentët e MAR janë përcaktuar në Shqyrtimin Periodik të bërë në vitin 2018 dhe mbesin të vlefshme për një periudhë pesëvjeçare. Shqyrtimi aktual ka të bëjë me vlerësimin e propozimeve për MAR të paraqitura nga kompanitë e rregulluara, duke marrë në konsideratë edhe të dhënat aktuale të vitit 2019, në mënyrë që të vijmë deri te përcaktimi i të hyrave për vitin relevant tarifor 2020. Ky shqyrtim vlerëson nëse propozimet e të licencuarve janë llogaritur në përputhje me kërkesat ligjore.

ZRRE fton kompanitë e licencuara, konsumatorët dhe të gjitha palët tjera të interesit, që të japin kontributin e tyre në këtë proces, duke shqyrtuar dhe komentuar të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimi dhe Tregut (OST/OT). Këto raporte duhet të analizohen, duke ju referuar gjithashtu edhe raporteve përfundimtare të Shqyrtimit Periodik 2018-2022.

Palët të cilat dëshirojnë të paraqesin komentet e tyre eventuale rreth propozimeve të ZRRE-së, ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se **4 mars 2020**. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në adresën:

*Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë*

Dokumentet relevante

Vlerësimi përfundimtar i MAR të OST/OT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar

http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KOSTT_PRR2_final.pdf



Aplikimi tarifor i KOSTT për vitin 2020

http://www.ero-ks.org/2020/Tarifat/200121_KOSTT_Azhurnimet%20Vjetore%20te%20te%20hyrave%20maksimale%20te%20lejuara_2019-2020.pdf

2 Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

Bazuar në Rregullën për Vendosjen e të Hyrave për OST/OT, ZRRE ka analizuar me kujdes të gjithë komponentët e kostove dhe kërkesat e të licencuarit të paraqitura në aplikacionin e tij për të Hyrat e Lejuara Maksimale. Gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE përdor vlerat e vendosura gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik 2018-2022 dhe përshtat MAR-in për të reflektuar ndryshimet në mes të kostove që kanë qenë të parashikuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostove aktuale të arsyeshme të kompanive të rregulluara. Gjatë këtij procesi ZRRE do të:

1. Indeksujë Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indeksset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) për vendet e Eurozonës;
2. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSCt) për OST, dhe t'i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë ndodhur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e Transmetimit;
3. Azhurnojë MAR-in e OST/OT-së në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1);
4. Azhurnojë parashikimet e kostove të lejuara të shërbimeve ndihmëse;
5. Caktojë MAR-in e OST/OT-së për Vitin Relevant t.

3 Bilanci i Energjisë

Në këtë shqyrtim tarifor ZRRE ka përdorur bilancin e aprovuar për të marr parasysh konsumin e përditësuar dhe vlerësimin për dërrgullimin e konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35kV. Megjithatë, kërkesa në OST, pavarësisht derregullimit të konsumatorëve fundorë, duhet të reflektojë kërkesën e përgjithshme të sistemit, duke përfshirë kërkesën e konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar. Implementimi i ndryshimeve ligjore në kuadër të liberalizimit të tregut ka një ndikim esencial në trajtimin e humbjeve në sistemin e energjisë elektrike. Bilanci i azhurnuar do të përdoret për të llogaritur blerjet e energjisë me shumicë për mbulimin e humbjeve të transmetimit, shpërndarjes dhe tarifën me pakicë për Shërbimin Universal.



3.1 Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar

Me qëllim të vlerësimit të kostove që kanë të bëjnë me blerjen e humbjeve në nivel të OST-së, ZRRE ka analizuar të dhënat e raportuara nga KOSTT për vitin 2019 dhe të dhënat për parashikimin e bilancit për vitin 2020. Për parashikimin e bilancit të vitit 2020, ZRRE ka marrë për bazë Bilancin e aprovuar.

Parashikimi i bilancit të energjisë elektrike për vitin 2020 është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 1: Bilanci i energjisë elektrike në OST

Bilanci i energjisë elektrike ne OST	Njësia	2020 Propozimi
a) Hyrja ne OST	GWh	6,244
b) Eksporti	GWh	409
c) Konsumi ne OST (llomag dhe kons 220kV dhe 110 kV)	GWh	770
d) Humbjet në OST	GWh	111
	%	1.78%
e =a-b-c-d Dalja e energjisë nga Transmetimi/hyrja në OSSH	GWh	4,948

Humbjet e tejkaluara në nivel të transmetimit prej 5.9GWh të përfshira në rrjedhat e energjisë në transmetim të paraqitura në tabelën e më sipërme, nuk do të përdoren për kalkulimin e kostove të humbjeve. Furnizimi i katër komunave të veriut të Kosovës nuk është paraparë të bëhet nëpërmjet blerjeve të energjisë në tregun me shumicë, duke marrë në konsideratë vendimin e gjykatës në lidhje me furnizimin e katër komunave të veriut të Kosovës, andaj energjia e tillë nuk është trajtuar si konsum, respektivisht nuk janë paraparë blerjet e energjisë për të balancuar atë kërkesë.

Importi i energjisë përfshinë energjinë e nevojshme për mbulimin e konsumit të konsumatorëve të kështu në nivel të OST-së, energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e OST-së dhe OSSH-së, si dhe furnizimin e konsumatorëve me Shërbim Universal dhe konsumatorët e derregulluar në OSSH. Diferenca është kalkuluar si eksport me qëllim të barazimit të bilancit.



4 Përshtatjet e rregullta

Në këtë pjesë janë paraqitur kalkulimet lidhur me përshtatjet e rregullta vjetore të vitit 2019. Kalkulimi i këtyre përshtatjeve do të përfshihet gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin relevant tarifor 2020.

4.1 Përshtatjet për normën e inflacionit

Për të bërë kalkulimin e përshtatjeve lidhur me normën e inflacionit, si referencë është marr norma e inflacionit e publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2019 ishte 1.19%¹. Mënyra për kalkulimin e përshtatjeve të tilla është e përcaktuar në Rregullën e të Hyrave të OST/OT-së.

Kjo normë aplikohet në përshtatjen e kostove operative, kostove të zhvlerësimit dhe kthimit në kapital. Pas aplikimit të normës së inflacionit prej 1.19% ndaj komponentëve të kostove të sipërpërmendura, rrjedh vlera e kostove të përshtatura prej 0.33 milion euro. Përshtatjet që kanë rezultuar nga aplikimi i normës së inflacionit për secilën nga komponentët e kostove të lejuara në vitin 2019 i janë shtuar më pastaj vlerësimit fillestar të kostove për vitin 2020, të përcaktuara gjatë shqyrtimit periodik. Detajet e këtyre kalkulimeve janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 2: Përshtatjet për inflacion

Linja	Njësia	a) Lejuar 2019	b) Përshtatja për HICP	c) Vlerësimi fillestar 2020 ²	d=b+c Lejimi 2020
OPEX-i	mil €	7.42	0.09	7.19	7.28
Zhvlerësimi	mil €	10.63	0.13	11.21	11.33
Kthimit	mil €	9.59	0.11	10.21	10.32
Total	mil €	27.64	0.33	28.61	28.93

4.2 Përshtatjet tjera në OPEX

ZRRE gjatë shqyrtimit periodik 2018-2022 ka lejuar kosto shtesë në OPEX, të cilat ndërlidhen me operimin e nënstacionit të Vallaqit. Duke qenë se këto kosto nuk janë realizuar gjatë vitit 2018 dhe 2019, ZRRE ka bërë përshtatjet e këtyre kostove. Vlera e këtyre përshtatjeve është 0.16 milion euro. Trajtimi i këtyre kostove do të bëhet ngjashëm edhe në vitin 2020 në rast se ato nuk realizohen.

¹ Burimi: Eurostat, <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do> (vizituar më 27.01.2020)

² Sipas lejimeve të Shqyrtimit Periodik 2018-2022 linku:

http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KOSTT_PRR2_final.pdf



4.3 Investimet kapitale

KOSTT në dokumentacionin e dërguar ka kërkuar projekte shtesë krahas atyre të lejuara gjatë procesit të shqyrtimit shumëvjeçar. Dokumentacioni që është ofruar nga KOSTT ka një përshkrim të përgjithshëm për nevojën e realizimit të këtyre projekteve. Me qëllim të vlerësimit të arsyeshmërisë teknike dhe financiare të këtyre projekteve dhe kostove që ndërlidhen me to, ZRRE kërkon që KOSTT të bëjë vlerësimin e këtyre projekteve në përputhje me Rregullën për vlerësimin e Investimeve kapitale, sipas së cilës duhet të analizohen parametrat teknik dhe ekonomik si CBA, NPV, kostot për njësi, alternativat si dhe përshkrimin e punëve që ndërlidhen me projektet e tilla.

Në mungesë të parametrave të sipërpërmendur si dhe numrit të madh të projekteve të cilat ndryshojnë në masë të madhe planin investiv të aprovuar për periudhën pesëvjeçare, në këtë fazë të konsultimit, ZRRE nuk ka mundur të vlerësojë arsyeshmërinë e këtyre projekteve, andaj ato, në parim nuk janë pranuar në këtë fazë të shqyrtimit.

Bazuar në Rregullën për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes, të licencuarit pritët që të zbatojnë Planin Investiv Pesëvjeçar në mënyrë të plotë përveç në rastet, kur gjatë periudhës rregullative, projektet ose programet individuale identifikohen se më nuk janë të nevojshme ose mund të zëvendësohen me alternativa që ofrojnë rezultate ekuivalente, me një kosto më të ulët për jetëgjatësinë e tyre. Prandaj devijime të vazhdueshme vjetore nga plani investiv janë mjaft shqetësuese për Rregullatorin dhe si të tilla është shumë e vështirë të trajtohen brenda procesit të azhurnimeve të rregullta vjetore, duke pasur parasysh që çdo projekt i ri duhet t'i nënshtrohet konsultimeve publike dhe duhet të mbështetet me analiza të detajuara e të cilat kërkojnë kohë më të gjatë për shqyrtim. Është e kuptueshme që mund të ketë devijime në realizimin e planit investiv nëpër vite, mirëpo këto devijime duhet të jenë të arsyeshme dhe ndikimi i tyre të jetë minimal për sistemin dhe konsumatorët, në rast se shumica e tyre realizohen brenda periudhës rregullative.

4.4 Faktori ndarës i kursimeve

Përveç përshtatjeve të sipërpërmendura, ZRRE ka bërë edhe përshtatjet e kostove të mirëmbajtjes duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve. Këto përshtatje aplikohen me qëllim të nxitjes së kursimit nga ana e kompanisë, ku pjesa e kursyer do të ndahet në mes të kompanisë dhe konsumatorëve me një faktor ndarës prej 50%. Nga analiza e bërë, vlera e rezultuar e kursimit është 0.38 milion euro, ku vlera e përshtatur e kursimeve pas aplikimit të faktorit ndarës është 0.19 milion euro (pjesa për të cilën kompensohen konsumatorët).

4.1 Fondi për BRE

Nga analizimi i aplikacionit të KOSTT, vërehet se ka një dallim ndërmjet kostove dhe të hyrave nga fondi i BRE-ve për vitin 2019. Vlera e këtij dallimi është -2.86 milion euro, dhe ato përfshijnë dallimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit të BRE për vitin 2019 dhe përshtatjet për kostot e menaxhimit të Fondit për vitin 2018 dhe 2019. Këto të hyra (si të zbritshme) janë marrë parasysh gjatë kalkulimit të kostove aktuale AAC_{t-1} .



Parashikimi i kostove të fondit të BRE-ve është bërë duke u bazuar në bilancin e energjisë të aprovuar për vitin 2020, i cili ndër tjera, merr parasysh prodhimin e energjisë elektrike nga BRE. Vlera e kostove të fondit duke marrë parasysh çmimin referent (i cili përfshinë blerjet me shumicë të energjisë në tregun vendorë dhe importin) ka rezultuar që për vitin 2020 të jetë 17.8 milion euro.

4.2 Përshtatjet e kostove të humbjeve

Përshtatja e kostove të humbjeve për OST bëhet përmes formulës së mëposhtme:

$$(LSSCat-1 - LSSCft-1) * (1 + It)$$

Vlera e kostos së përshtatur për humbje është -1.0 milion euro, e cila rezulton për shkak të rrjedhave më të ulta të energjisë të realizuara kundrejt atyre të parashikuara dhe çmimit mesatar më të ulët për blerjen e humbjeve për vitin 2019 në rrjetin e transmetimit. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3 Përshtatjet për kostot e humbjeve

OST/OT MAR	Njësia	E lejuar 2019	E realizuar 2019	E propozuar 2020
Parametri i indeksimit				
It	%		7.38%	
Humbjet e lejuara (LSSCt)				
LSSAt	%	1.78	1.78	1.78
REUEt	GWh	6,395	6,070	6,238
WHEAt	€/MWh	47.76	42.37	46.46
Humbjet në OST me ngarkesën e veriut	GWh		108.0	
Humbjet e përshtatura për shkak të ngarkesës në veri	GWh	4.96	5.3	
Humbjet e lejuara	GWh		102.7	
LSSCat-1	mil €		4.35	
LSSCft-1	mil €	5.40		5.16
Kostot e përshtatura³	mil €		-1.0	

Po ashtu janë përshtatur kostot e humbjeve të vitit 2018 ngjashëm sikurse ato të vitit 2019, që ndërlidhen me ngarkesën e veriut. Vlera e energjisë së përshtatur me këtë ngarkesë është rreth 5GWh. Megjithatë gjatë vlerësimit përfundimtar, KOSTT duhet të ri-konfirmojë ngarkesën në nivel të OST-së për vitin 2018 dhe humbjet që ndërlidhen me veriun.

³ Këto kosto janë pjesë e azhurnimeve të përgjithshme dhe reflektohen në MAR-in e vitit 2020.



Ku :

$LSSA_t$	<i>janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t</i>
$REUE_t$	<i>janë njësitë e energjisë (MWh) apo (GWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t</i>
$WHEA_t$	<i>është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t</i>
$LSSCa_{t-1}$	<i>është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)</i>
$LSSCf_{t-1}$	<i>është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)</i>
I_t	<i>është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it</i>

Shënim: Energjia e përdorur për qëllim të kalkulimit të kostove të humbjeve të vitit 2020 e paraqitur në tabelën 3 është në vlerë prej 6,238GWh dhe kjo dallon me energjinë e hyrë në transmetim të paraqitur në tabelën 1 në vlerë prej 6,244GWh. Ky dallim prej 6GWh i atribuohet tejkalimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit në raport me nivelin e lejuar nga ZRRE, dhe ato nuk merren parasysh gjatë kalkulimit të kostove të humbjeve.

Lidhur me energjinë e realizuar në vitin 2019 në vlerë prej 6,070GWh, kjo sasi e energjisë dallon nga raportimet mujore për të njëjtën periudhë. Sidoqoftë pas ri-konfirmimit të KOSTT, ZRRE ka marrë për bazë këtë vlerë të energjisë (6,070GWh), megjithatë në vlerësimin përfundimtar të MAR-it të KOSTT, kjo duhet të konfirmohet dhe të shpjegohet dallimet me raportimet mujore në ZRRE.

ZRRE në vlerësimin preliminar ka parashikuar kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve bazuar në çmimet aktuale të realizuara në vitin 2019, por gjatë procesit të konsultimit publik, palët duhet të ofrojnë dëshmi se kanë respektuar parimet e përcaktuara në kornizen ligjore dhe rregullative për shitblerje të energjisë për mbulimin e humbjeve.

4.3 Përshtatjet për të hyrat jo tarifore

Të hyrat tjera të realizuara nga aktivitetet e pa-rregulluara siç janë: të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, shitja e aseteve, nga mekanizmi kompensues ndërmjet TSO (ITC), zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale. Vlera e këtyre të hyrave të realizuara është raportuar nga KOSTT në aplikimin e tyre në vlerë prej 1.11 milion euro.



4.4 Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2019. Parimi i cili aplikohet ka të bëjë me vlerësimin e përgjithshëm të kostove të lejuara aktuale dhe të hyrave aktuale të realizuara. Këto llogaritje janë bërë sipas formulës në vijim:

$$KREV_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

AAC_{at-1} *Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Allowed Cost as determined in Relevant Year t-1")*

ARR_{t-1} *Paraqet të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1 ("is the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")*

I_t *Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra*

Ndryshimi në mes të AAC_{at-1} prej 33.90 milion euro dhe ARR_{t-1} prej 37.37 milion euro, pas aplikimit të normës së interesit rezulton të jetë -3.72 milion euro. Ky ndryshim ndërmjet të hyrave dhe kostove aktuale të lejuara bartet si azhurnim gjatë përcaktimit të MAR për vitin 2020.



5 Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT-në janë llogaritur sipas formulës në vijim:

$$MARt = OPMct + DEPCt + RTNct + ASVct + LSSct + LICct - ITCR - NTFR t + ADJt + KREVt$$

Ku janë:

MARt - Të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t

OPMct - Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t

DEPCt - Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t

RTNct - Kthimi i kostos së kapitalit i lejuar në vitin relevant t

ASVct - Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse në vitin relevant t

LSSct - Kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t

LICct - Kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t

ITCRt - Të hyrat neto të OST/OT nga mekanizmi kompensues ndër-OST në vitin relevant t

NTFR t - Të hyrat jo tarifore në vitin relevant t

ADJt - Përshtatjet e kostove

KREVt - Faktori korrigjues i të hyrave në vitin relevant t

Rezultatet e kalkulimeve për këta komponentë janë paraqitur në tabelën më poshtë.



Tabela 1 - Propozimi i MAR të OST/OT

Te hyrat e lejuara maksimale	Lejuar 2018	Lejuar 2019	Propozuar 2020
Parametrat e indeksimit			
Faktori i efikasitetit		1.5%	1.5%
HICP	1.73%	1.19%	
Euribor	-0.11%	-0.2%	
Faktori S	7.60%	7.60%	
Norma e interesit - It	7.49%	7.38%	
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPMct)			
Vlerësimi gjate PRR2		7.30	7.19
Lejuar -OPMct = OPMct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Et)* (1 – Pt)	7.42	7.42	7.28
Përshtatjet e kostove të mirëmbajtjes:	1.08	1.06	
Aktuali	0.49	0.68	
Dallimi duke aplikuar faktorin ndarës 50/50	-0.29	-0.19	
Përshtatjet për OPEX për Vallaq		- 0.16	
Kostot e zhvlerësimit (DEPct)			
Vlerësimi gjate PRR2		10.46	11.21
Lejuar - DEPct = DEPct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Pt)	9.53	10.63	11.33
Kostot e kthimit (RTNct)			
Vlerësimi gjate PRR2		9.44	10.21
Lejuar - RTNct = RTNct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Pt)	8.52	9.59	10.32
Kostot e humbjeve (LSSct)			
Parashikim			
LSSAt	1.78%	1.78%	1.78%
REUEt	5,844	6,395	6,238
WHEAt	44.00	47.46	46.46
Kosotja e parashikuar e humbjeve	4.58	5.40	5.16
Aktual			
LSSAt	1.78%	1.78%	1.78%
REUEt	6,203.70	6,070	-
WHEAt	44.82	42.37	-
Kostoja aktuale e humbjeve ⁴	4.73	4.35	-
Fondi			
Parashikim	2.87	13.74	17.78
Aktual	(1.54)	(2.86)	
Përshtatjet për inflacion te BRE-ve		0.41	
Shërbimet e ndihmëse			
Parashikim	2.59	2.66	2.73
Aktual	-	-	
Përshtatjet			

⁴ Përshtatur për ngarkesën e veriut



Të hyrat e parregulluara

Parashikim

(0.06)	(0.06)	(0.06)
--------	--------	--------

Aktual

(0.41)	(0.25)	
--------	--------	--

Të hyrat nga mekanizmi ITC

Parashikim

(0.40)	(0.40)	(0.40)
--------	--------	--------

Aktual

(0.64)	(0.86)	
--------	--------	--

Përshtatjet për (2017 dhe PR1)

(1.26)	(1.26)	(1.26)
--------	--------	--------

Te hyrat nga KEK:

Parashikim

(3.33)	(3.33)	(3.33)
--------	--------	--------

Aktual

(2.67)	(2.77)	
--------	--------	--

Korrigjimi i jobalanceve 2017 dhe 2018

0.23		
------	--	--

KREV – faktori korrighues i të hyrave

Faktori korrighues i te hyrave t-1

9.61	-3.72	
------	-------	--

AACt-1 - kostot aktuale për vitin t-1

23.39	33.90	
-------	-------	--

ARRt-1 - te hyrat aktuale për vitin t-1

14.45	37.37	
-------	-------	--

KREvt = (AACat-1 – ARRt-1) * (1+ It)

9.61	-3.72	
-------------	--------------	--

MAR – te hyrat e lejuara maksimale

30.48	54.25	45.84
--------------	--------------	--------------

Si rezultat i kalkulimeve të secilit komponent të kostove, MAR i propozuar për OST/OT për vitin 2020 është 45.84 milion euro.